

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

Sot me date 13/11/2024 i nenshkruari **Orges Shehaj** lindur me 09/01/1982 ne Fier, shtetas Shqiptar, mbajtes i kartes se identitetit me nr 032736869 dhe ID I20109101R dhe i nenshkruari **Gezim Leka**, lindur me 17/07/1976 ne Selbe, Tirane, shtetas Shqiptar, mbajtes i kartes se identitetit me nr 036430086 dhe ID H60717045D

Ne baze te ligjit 9901 date 14/04/2008 "per Tregtaret dhe shoqerite Tregtare" dhe ligjit 9723 date 03/05/2007 per QKR, kane vendosur te themelojne shoqerine tregtare SH.P.K te emertuar **2G KONSTRUKSION**. Duke nenshkruar kete Akt Themelimi. Aktiviteti i saj do te rregullohet nga statuti i saj i cili do te jete pjese perberese e ketij ketij themelimi

Neni 1- Emertimi i shoqerise

Shoqeria eshte person juridik I te drejtes shqiptare, **SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**. (me poshte e quajtur "SHOQERIA")

Neni 2 - Objekti i veprimtarise

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë **2G KONSTRUKSION** sh.p.k do të shtrihet në këto fusha veprimi:

Aktivitet ne fushen e ndertimit te objekteve te ndryshme industriale dhe civile, privat apo publike; Aktivitet ne fushen e sherbimeve te ndryshme teknike ne vepra industriale dhe civile; Zhvillimi i zonave rezidenciale dhe tregtare; Shitjeblerje e pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme, ndermjetesimi ne shitjen, blerjen, qeradhenien e pasurive te paluajtshme dhe menaxhimi i tyre; Ushtrimi i cdo lloj operacioni dhe transaksioni ne lidhje me importimin, eksportimin, prodhimin, tregtimin, shitjen, shperndarjen e mallrave , pajisjeve dhe materialeve te ndryshme. Projektim, supervizion dhe kolaudim ne objektet civile, industriale, turistike.

Neni 3 – Selia

Shoqëria e ka selinë ne qytetin **Tirane**, rr. **Jordan Misja**, nd. **52**, hyrja **6**, ap. **14**

Përveç veprimtarisë në nivel lokal, shoqëria ka të drejtën e krijimit dhe mbylljes së filialeve, agjencive dhe zyrave të përfaqësimit brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Selia mund të transferohet në çdo vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me një vendim të Ortakeve te kesaj shoqerie.

Shoqeria sipas parashikimeve te ketij statuti dhe legjislacionit ne fuqi, mund te hape si ne Shqiperi dhe jashte saj, qendra, perfaqesi, filiale, dege dhe shoqeri te tjera.

Gezim Leka



ORGES SHEHAJ



Neni 4- Kohezgjatja

Kohezgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë pa afat, duke filluar prej datës së rregjistrimit të saj në Rregjistrin e Shoqërive Tregtare pranë Qendës Kombëtare të Rregjistrimit. Ky afat mund të ndryshohet një ose më shumë herë, me vendim të asamblesë së ortakëve.

Neni 5 – Kapitali aksionar

Kapitali është fiksuar në lek 100 000 (njëqind mijë) leke. I ndarë në 2 (dy) kuota në zotërim si mëposhte:

1. Orges Shehaj 1 (një) kuota me vlerë 50 000 (pese dhjetemije) leke.
2. Gezim Leka 1 (një) kuota me vlerë 50 000 (pese dhjetemije) leke.

Kuotat e pjesëmarrjes janë në zotërim të:

1. Orges Shehaj, dhe përqindja e pjesëmarrjes 50 %.
2. Gezim Leka, dhe përqindja e pjesëmarrjes 50 %.

Neni 6- Administrimi

Shoqëria administrohet nga një ose disa administrator, qofshin këta dhe jo ortak, të cilët emërohen ose shkarkohen nga Asambleja e zakonshme. Administratori/et qëndrojnë në postin e tyre për pesë vjet financiare, me mundësi për të rizgjedhur.

Administratori/et kanë të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretet, në interes të shoqërisë dhe në emër të saj, në të gjitha rrethanat që kanë lidhje me objektin e Shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji apo statuti i saj jep Asamblesë së Ortakëve.

Shoqëria do të funksionojë me 1 (një) administrator. Administratori e saj mund të marrin vendime sipas nevojave në përputhje me statutin dhe aktin e themelimit të shoqërisë.

Administratori i shoqërisë është **Orges Shehaj**. Ai do të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme për rregjistrimin e shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit (QKR).

Të gjitha shpenzimet që do të kryen deri në rregjistrimin e shoqërisë si person juridik do të përfshihen në bilancin e shoqërisë.

Neni 7- Ekspertët Kontabel të Autorizuar.

Shoqëria do të kontrollohet nga një ose disa eksperte kontabel të autorizuar të zgjedhur nga lista e Institutit të Eksperteve Kontabel të Autorizuar. Në caktimin e eksperteve kontabel të autorizuar mbahen parasysh përjashtimet dhe papajtueshmëritë e përcaktuara nga ligji "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Gezim Leka



ORGES SHEHAJ



Eksperti/et kontabel te autorizuar emerohen nga asambleja e përgjithshme, ne afatet e parashikuara nga ligji, me te drejte rizgjedhje ne kushtet e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme.

Detyrimet dhe te drejtat e Eksperteve Kontabel te Autorizuar te shoqerise jane ato te parashikuara nga ligji "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare". Raportet qe ata pergatisin depozitohen ne seline e shoqerise, ne afatet e parashikuara nga ligji.

Neni 8- Viti financiar dhe bilanci vjetor.

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 dhjetor.

Viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit te Shoqerise ne Rregjistrin Tregtar, prane Qendes Kombetare te Rregjistrimit, dhe perfundon ne 31 dhjetor te te njejtit vit.

Pasqyrat financiare,raporti i administrimit dhe raporti i ekspertit/ve kontabel te autorizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme ne kushtet e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme.

Miratimi i dokumentave qe lidhen me vitin financiar duhet te behet brenda 6 (gjashte) muajve qe nga fundi i vitit financiar.


Neni 9 - Dispozita te pergjitheshme

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 kopje me permbajtje dhe vlera te njejta juridike ne gjuhen shqipe dhe u miratua nen per nen nga aksioneri themelues dhe u nenshkrua ne cdo flete me emer mbiemer dhe nenshkrim me vullnet te lire

ORTAKU THEMELUES

Orges Shehaj

ORGES SHEHAJ



ORTAKU THEMELUES

Gezim Leka

GEZIM LEKA

